

MONITOR:

ZBATIM I REFORMAVE URGJENTE PRIORITARE

Период: 21.10-06.11.2015

Zbatimi i marrëveshtjes politike

Zbatimi i Marrëveshtjes politike u bë kritik. Nënshkruesit e Marrëveshtjes u penguan përreth përcaktimit të mandateve të ministrave të rinj dhe zavendës ministrave. Njëpasnjë, kjo kontribuoi në rrjedhën e negociatave dhe të pyetjeve të tjera të rëndësishme, duke kyçur dhe kodin zgjedhor për të cilin më parë ishin dakorduar. Mediatori Vanhoute e ndryshoi formatin e deritanishëm të negociatave me mbajtjen e takimeve bilaterale të cilat e arritën kulmi me marrëveshtjen përfundimtare të 5 nëntorit.

Faktori ndërkombëtar bëhet gjithnjë e më i zëshëm me kërkesat që të respektohet Marrëveshja, duke nënvizuar se kjo do të pasqyrohet mbi rekomandimin, për fillimin e negociatave me BE-në. Ambasadorët e SHBA, Francës, Italisë, Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë prej para Qeverisë së RM-së, e shprehën shqetësimin për ngecjen e zhvillimeve politike të ngjarjeve. Kësaj radhe ata publikisht e thërritën VMRO-DPMNE dhe Gruevskin të manifestojnë angazhim për implementimin e Marrëveshjes, konstruktivitet, vullnet të mirë dhe emergjencë, në mënyrë që të gjendet zgjidhje për çështjet e hapura për implementimin e shpejtë të reformave. Sa i përket LSDM-së, theksuan se edhe më tutje duhet të vazhdojnë t'i plotësojnë obligimet e ndërmarra, përkatësisht të mos publikojnë regjistrime nga bisedat e përgjuara.¹ Përveç ambasadorëve, mesazh të njëjtë adresoi edhe Berlino zyrtar.² Këtyre qëndrimeve iu bashkëngjitën edhe "Progresistët" nga Parlamenti Evropian.³ Hoviti ish-referuesi për Maqedoninë, theksoi se është tepër vonë për një rekomandim të njëjtë pozitiv si ai i vitit të kaluar, përkatësisht paralajmëroi kushtëzim.⁴

Gjysmë ore pas reagimit të ambasadorëve, Kryeministri Gruevski në Tuitër profilin e tij e publikoi qëndrimin e Qeverisë se "Populli vendos për ardhmërinë e Maqedonisë".⁵

Presioni kësaj radhe dha fryte. Pas deblokimit të punës së Prokurorisë Speciale Publike, u deblokua edhe zbatimi i Marrëveshjes. Në mbrëmje të datës 5 nëntor, ekipet negociuese të partive u ulën në tryezë të përbashkët dhe arritën Marrëveshje rreth Ligjit të ri për Qeverinë, Kodin penal, Ligjin për "bombat", Ligjin për "bilbilfryrësat" dhe Komisionin Anketues në lidhje me skandalin e përgjimeve. Kuadro të shquara partiake nga radhët e LSDM-së do të jenë pjesë të Qeverisë kalimtare.⁶ Data e mbajtjes së zgjedhjeve mbetet e njëjtë.

Ministrat e opozitës do të kenë të drejtë për ndryshime kadrovike, por sa i përket çdo funksionari të caktuar nga ana e tyre, zëvendësi do të jetë nga VMRO-DPMNE. Zëvendësministrat nga dita e parë të emërimit të tyre do ta kenë të drejtën e vetos për çështje që kanë të bëjnë me zgjedhjet, ndërkaq në rast të interpretimeve të ndryshme kompetent do të jetë KSHZ.

Ligji për "bombat", i emërtuar si Ligj për mbrojtjen e privatësisë të garantuar me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut, ka të bëjë vetëm me materialet e regjistruara në mënyrë jolegale brenda periudhës kohore të vitit 2008/2015, megjithatë nuk parashikon kurrfarë ndëshkimesh nëse përdoren bisedat telefonike tanimë të publikuara. Ndalimi i publikimit ka të bëjë me materialet të cilat e rrezikojnë privatësinë por jo edhe për materialet me

¹ Reagimi është i aksesshëm në ueb-faqen e Ambasadës së Britanisë së Madhe: <https://www.gov.uk/government/world-location-news/joint-statement-on-political-crisis-in-macedonia>.

² Reagimi është i aksesshëm në ueb-faqen e Ambasadës së Gjermanisë: http://www.skopje.diplo.de/Vertretung/skopje/mk/_pr/Presse2015/Pressemitteilungen/Reichel-Okt2015.html

³ Përfaqësues të grupit të socialistëve dhe demokratëve progresive në Parlamentin Evropian: Xhani Pitella (kryetar i Grupit), Riçard Hovit dhe Kurt Fllekenshtajn, realizuan vizitë në Maqedoni më 4 nëntor me rastin e pjesëmarrjes në debatin publik të titulluar si "Sfidat dhe pritshmëritë nga situatat aktuale politike dhe perspektivat Evropiane", i organizuar nga Fondacioni "Fridrih Ebert" - Zyra në Shkup, në bashkëpunim me "Institutin për Progres". Gjatë vizitës, delegacioni Pitella-Hovit u takua me Zoran Zaev-in, ndërsa u mbajt takim edhe me Ministrin e punëve të jashtme Nikolla Popovski, në përbërje Pitella-Fllekenshtajn.

⁴ Hovit: Marrëveshja e Przhinos u shkel, Tellma 04.11.2015, i aksesshëm në: <http://www.telma.com.mk/vesti/hovit-dogovorot-od-przhino-e-prekrshen>

⁵ Gruevski: Populli i Maqedonisë vendos për ardhmërinë e tij. Ueb faqja e Qeverisë së RM-së 23.10.2015. I aksesshëm në: <http://vlada.mk/node/11338>

⁶ Oliver Spasenovsk si Minister i Punëve të Brendshme, Frosina Remenski Ministre për Punë dhe Politikë Sociale, Kire Naumov si zëvendësministër në Ministrinë e Financave, Aleksandar Kiracovski në Administratë dhe Ljupčo Nikolovski në Bujqësi. Ministrat e deritanishëm për punë të brendshme dhe për punë dhe politikë sociale mbesin në këto ministri si zëvendësministra.

interes publik. Për ligjin e këtitillë do të kërkohet mendim nga Komisioni i Venecias, me ç'rast zbatimi i tij shtyhet për gjashtë muaj. Ligji për "bilbilfryrësat" do t'i mbrojë bashkëpunëtorët e drejtësisë në institucionet shtetërore por edhe në kompanitë private dhe i njëjti do të fillojë të zbatohet katër muaj pas votimit të tij. Në cilësi të këtitillë mund të paraqitet çdo punonjës, kandidat për punësim, vullnetar ose person i cili në cilëndo qoftë bazë është i angazhuar me punë.

Megjithatë, ligjet publikisht nuk u publikuan.⁷ Është paralajmëruar se ato do të gjenden para deputetëve në "afat sa më të shpejtë" përkatësisht të hënën meqë grupet e punës të partive duhet t'i precizojnë "detajet teknike të procedurave".

Komisioni Evropian i inkurajon partitë që t'i ndërmarrin hapat e duhur në drejtim të implementimit të obligimeve nga Marrëveshja e qershorit/korrikut... e që është e rëndësishëm në kontekstin e raport-progresit që paraprinë.⁸

Sundimi i së drejtës dhe gjyqësori

Gjyqësori

Pas shkëljes së afatit ligjor prej 35 ditësh për sigurimin e mjeteve financiare, Kuvendi unanimisht dhe pa diskutim e miratoi buxhetin e propozuar për Prokuroren Speciale Publike në lartësi prej 63.420.428 denarë për tremujorin e fundit të vitit 2015.⁹ Këshilli i Prokurorëve Publik të Republikës së Maqedonisë vendosi ta ndryshojë vendimin dhe votoi edhe pesë Prokurorë Publik të cilët do të punojnë me shtatë Prokurorët paraprakisht të zgjedhur në ekipin e Katica Janevës. Prokurorët Publik të zgjedhur do të kenë mundësi që në mënyrë autonome të zgjedhin nga dy hetues dhe dy bashkëpunëtor profesionist. Prokuroria Speciale Publike e formatuar në këtë mënyrë, e vendosur në ish-hapësirat e Agjencisë për rini dhe sport, paralajmëroi se me punë do të fillojë më datë 9 nëntor (E Hënë).¹⁰

Gjykata e Apelit Shkup u shpall jokompetente për të vendosur për ankesat e paraqitura të prokurorëve themelore publikë kundër vendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake me të cilat u hodhën poshtë si prova përgjimit e regjistruara, të publikuara nga opozita. Vendimi i këtitillë është në përputhje me Ligjin për procedurë penale, i cili parashikon se sa u përket ankesave të vendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake, kompetente është gjykata e shkallës së parë me kolegji të përbërë nga tre gjyqtarë. Në bazë të kësaj rezulton se gjyqtarja e procedurës paraprake ka dhënë këshillë të gabuar juridike se para cilës gjykatë prokuroria duhet të paraqesë ankesë. Lënda i është kthyer Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup.¹¹ Gjykata themelore i hodhi poshtë ankesat si pabazë dhe mbështeti vendimin e gjykatësit të hetimit paraprak.¹²

Këshilli Gjyqësor në seancën e mbajtur më 30 tetor, ka konstatuar se për shkak të pushimeve vjetore nëpër gjykata ka një numër të madh të lëndëve të pazgjidhura. U miratua Rregullore e re për punë, në bazë të së cilës Këshilli Gjyqësor duhet të përpilojë procedura të reja interne për punë. Lidhur me konkursin e shpallur për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit për përcaktimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për konstatimin e përgjegjësisë të gjyqtarit nga radhët e profesorëve të pensionuar universitarë të fakulteteve juridik të universiteteve në Republikën e Maqedonisë procedura ka përfunduar, pason testi psikologjik, dhe pas kësaj do të bëhet shpallja e kandidatëve.¹³ Megjithatë më 4 nëntor të vitit 2015 sërish u shpall konkurs për zgjedhjen e anëtarit nga radhët e pjesëtarëve të bashkësive të cilat nuk janë shumicë në RM.¹⁴ Me kërkesë për transparencë më të madhe të procedurës, Komisioni për zgjedhje iu referua mbrojtjes të integritetit të kandidatëve për anëtarë. Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë nismën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të dispozitës në të cilën parashikohet që vetëm pensionistë të mund të kandidohen për anëtarë të Këshillit.

Gjykata Supreme e RM më datë 29 tetor e shënoi 70 vjetorin e ekzistimit të vet. Në fjalën përshëndetëse, kryetarja Lidija Nedelkova deklaroi se krahas faktit se gjyqësori në Maqedoni ballafaqohet me probleme dhe dobësi të caktuara të cilat duhet të tejkalohen, perceptimi i publikut për gjyqësorin më shumë mbështetet mbi kritika kuturu të

⁷ Informatat lidhur me përbajtjen e tyre u publikuan nga mediat në bazë të burimeve të opozitës

⁸ KE: Marrëveshja të zbatohet. MIA 06.11.2015 <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/282/132881822>

⁹ Seanca nr. 71 e Kuvendit të RM-së. Materialet janë të aksesshme në: <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialId=1d09595a-e6d9-44f9-940f-165e9bcf4eb1>

¹⁰ Nga aktivitetet e monitorimit të Komitetit të Helsinkut për të drejtat e njeriut.

¹¹ Nga aktivitetet e monitorimit të Komitetit të Helsinkut për të drejtat e njeriut.

¹² Kumesë publike. Ueb faqja e Gjyqit themelor 1 Shkup. 04.11. viti 2015. I aksesshëm në: <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=427>.

¹³ Në ueb faqen e Këshillit gjyqësor akoma nuk ka njoftim nga Seanca e mbajtur më 30.10.2015. Instituti për të drejtat e njeriut rregullisht i ndjek seancat e Këshillit Gjyqësor.

¹⁴ Shpallje për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit për përcaktimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për konfirmimin e përgjegjësisë të gjyqtarit. I aksesshëm në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=361>

adresuara përmes dhe nga ana e mediave. Për këtë shkak kryetarja e Gjykatës Supreme apeloj që të ndërpritet tendenca negative në shoqëri dhe komploti publik kundër gjyqësorit.¹⁵

Nga themelimi i tij në vitin 2012 **Komisioni Ndërsektorial për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**, ka mbajtur dhjetë seanca në të cilat është shqyrtuar ekzekutimi i një pjese të madhe të aktgjykimeve të GJEDNJ kundër RM-së lidhur me ndërmarrjen e masave përkatëse individuale dhe të përgjithshme. Byroja për përfaqësimin e RM para GJEDNJ rregullisht i ekzekuton vetëm vendimet të GJEDNJ në pjesën e pagesës së just-satisfaction, të cilat rezultojnë nga aktgjykimet ose vendimet e Gjykatës (të miratuara në bazë të Marrëveshjes Paqedashëse ose Deklaratës Unilaterale) në afatin e parashikuar. Në fillim të vitit 2015, Byroja bashkë me Komitetin e Ministrave bëri një plan për paraqitjen e planeve/raporteve të veprimit në lidhje me aktgjykimet kundër Republikës së Maqedonisë në drejtim të përmirësimit të komunikimit me Komitetin sa i përket ekzekutimit dhe mbylljes së lëndëve të cilat tanimë janë ekzekutuar. Brenda këtij viti, deri më sot plotësisht janë mbyllur tri lëndë kundër RM-së, ndërsa gjithsej janë paraqitur 14 plane/raporte veprimi.¹⁶

Propozim Buxheti për vitin 2016, i cili hyri në procedurë parlamentare parashikon që Buxheti themelor i Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë të jetë në lartësi prej 41.403.000,00 mijë denarë, e që nënkupton rritje në krahasim me vitin 2015 kur ishte në një lartësi prej 31.293.000,00 denarë dhe në krahasim me vitin 2014 kur Buxheti themelor ishte në lartësi prej 34.946.000,00 denarë.¹⁷ Megjithatë, me rishikimin e Buxhetit të vitit 2014 Akademisë i janë shkurtuar mjete në lartësi prej 4.477.000,00 denarë, sipas raportit të Akademisë për vitin 2014.¹⁸

Propozim Buxheti për vitin 2016 parashikon program për reforma në gjyqësor të **Ministrisë së Drejtësisë** me qëllim të përmirësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të gjyqësorit, si dhe të klimës afariste përmes përforsimit të kapaciteteve gjyqësore dhe kapaciteteve të ministrive për implementimin e Strategjisë për reforma në gjyqësor, ligjeve të ndërlydhura dhe infrastrukturës gjyqësore. Për këtë qëllim janë akorduar 74.650.000,00 denarë për reforma në gjyqësor, të cilat janë shpërndarë në kategori për blerjen e mobileve, pajisjes dhe makinave, si dhe për punë ndërtime, ndërkaq trajnimet nuk figurojnë.

Ndjekja e komunikimeve

Me ftesë të drejtorit të DSK, anëtarët e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të Punës së Shërbimeve të Zbulimit realizuan vizitë në hapësirat e policisë sekrete. Por, në vend që të kthehet besimi ndaj këtij institucioni, pas takimit pasuan akuza të ndërsjella të anëtarëve. Kryetari i Komisionit Hari Llokenec deklaroi se nga vizita e realizuar nuk i kanë marrë përgjigjet e kërkuara por vetëm informata të pakta. Gjykata Supreme u prononcua negativisht lidhur me çështjen nëse nga viti 2007 ka lëshuar urdhër për ndjekjen e komunikimeve. Sipas kryetarit Llokenec, ekziston mospërputhje të numrit të urdhrave të lëshuar gjyqësor për vitin 2014 të publikuar nga Prokuroria Publike me numrin e urdhrave gjyqësorë për vitin e njëjtë, të evidentuara në DSK. Sipas Sazdovit, deputet nga radhët e VMRO-DPMNE, Llokenec duhet të përgjigjet penalisht për publikimin e të dhënave të këtilla.¹⁹

Komisioni Anketues në lidhje me skandalin e përgjimeve do të përbëhet prej 16 anëtarëve si vijon: 8 nga VMRO-DPMNE, 4 nga LSDM midis të cilëve edhe Kryetari dhe zëvendësi i Komisionit, 2 nga BDI, 1 nga PDSH dhe një deputet i pavarur. Mbledhjet e Komisionit sipas rregullit do të jenë publike, ndërsa çdo parti do të propozojë nga tre dëshmitarë. Raporti i Komisionit duhet të paraqitet në janar.

Lustrimi

Ueb-faqja e Komisionit për Verifikimin e Fakteve përsëri funksionon me atë që në faqen e parë ka informatë lidhur me Ligjin e ri.²⁰

¹⁵ Nga aktivitetet e monitorimit të Komitetit të Helsinkut për të drejtat e njeriut.

¹⁶ Informata është pranuar përmes së kërkesës për qasje të lire deri te informatat me karakter publik pranë Byrosë për përfaqësim të RM-së para GJEDNJ nga ana e Institutit për të drejtat e njeriut më 17 shtator 2015

¹⁷ Koalicioni Të Gjithë për gjykim të drejtë - burimi i informatave: ueb faqja Kuvendit dhe Akademisë, Raporti vjetor i Akademisë për vitin 2014

¹⁸ Në vitin 2014 Akademia realizoi 26.720.285,00 denarë, nga 30.469.000,00 denarë sa kanë qenë të alocurara me rishikimin e Buxhetit. Por konform llogarisë përfundimtare të Buxhetit të RM-së për vitin 2014, mjetet e akorduara të akademisë janë në lartësi prej 28.849.000,00 denarë. Kjo nënkupton se Akademisë gjithsej i janë shkurtuar 6.097.000,00 denarë në vitin 2014 dhe jo 4.477.000,00 denarë

¹⁹ Akuza pas vizitës së DSK. Tellma 27.10.2015. I aksesshëm në: <http://www.telma.com.mk/vest/obvinuvanja-po-posetata-na-ubk>.

²⁰ Han: Zbatimi i Marrëveshjes dhe zgjedhje të ndershme në prill. MIA-04.11.2015. I aksesshëm në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/380/132878587>

Reforma zgjedhore

Me ndryshimet e Kodit zgjedhor në lidhje me reklamimin politik, mediat tanimë nuk do të mund të paraqiten si donatorë, ndërsa shumica e përgjithshme për një votues kufizohet në 110 denarë. Pushteti dhe opozita do të kenë hapësirë të barabartë gjatë prezantimeve, nga 3 orë në servisin publik, 8 minuta për një orë program në mediat private dhe shpërndarje proporcionale të bilbordeve.

Këshilli nëntë anëtarësh i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve duhet të harmonizohet në afat prej 15 ditësh nga miratimi i Kodit zgjedhor, me atë që pushteti dhe opozita do të kenë nga tre anëtarë, ndërsa tre anëtarët e tjerë në mesin e të cilëve edhe kryetari do të jenë ekspertë.

Sipas mesazheve nga Komuniteti Ndërkombëtar, zgjedhjet doemos duhet të zbatohen në një teren të barabartë dhe ndërkombëtarisht të njihen. Komisioneri Han paralajmëroi monitorim të fuqishëm ndërkombëtar.²¹

Depolitizimi i administratës publike

Në prezencë të ministrit të Vetëqeverisjes Lokale dhe ministrit të Ekonomisë, 100 vullnetarëve nga spitali i përgjithshëm në Kumanovë, u janë dorëzuar vendime për transformimin e marrëdhënies së punës në pozita të përhershme.²² Vendimi i këtillë nuk është në përputhje me Prioritetet e Reformave Emergjente të cilat imponojnë moratorium të Ligjit për transformimin e punësimeve të përkohshme në pozita të përhershme përderisa parimi i meritës nuk është respektuar plotësisht në procesin e transformimit.

Media

Në Konferencën e sivjetme Speak Up3, Komisioneri Han theksoi se liria e shprehjes dhe medieve do të kenë rol qendror në procesin e zgjerimit dhe se kjo çështje nuk mund të jetë objekt i negociatave.

Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë kërkesën e Apostollovit dhe Kostovskës, gazetar dhe redaktore të Revistës Javore "Fokus" lidhur me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes së lirë të mendimit. Tekstet e publikuara në javoren "Fokus" nuk kanë pas për qëllim të nxisin debat publik, por t'u shkaktojnë dëm të drejtave personale të paditësit Mijallkov. Njëkohësisht Gjykata Kushtetuese konsideron se tekstet nuk i kanë respektuar parimet e gazetarisë investiguese, si dhe burimi i informatave, ish ambasador i RM-së, nuk mund të konsiderohet si faktor relevant.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është kontestues përkatësisht është në kundërshtim me Konventën për të drejtat e njeriut dhe praktikën e Gjykatës së Strazburgut madje hap edhe disa çështje esenciale: (1) Pse gjykata konsideron se tekstet të cilat kanë të bëjnë me sjelljen e bartësit të funksionit publik, në këtë rast, Drejtori i atëhershëm i DSK, nuk janë me interes publik?; (2) Pse ish ambasador, bartës i funksionit të lartë publik në shtet, nuk mund të llogaritet si burim relevant i informatave?²³

²¹ Në spitalin e Kumanovës 100 vullnetar i morën vendimet për punësim. MIA 29.10.2015. I aksesshëm në:

<http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/380/132869259>

²² Han: Vetëm përmes negociatave për anëtarësim mund të ndikojmë për gjendje më të mire mediatike. MIA 04.11.2015. I aksesshëm në:

<http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/98/132877476>

²³ Nga aktivitetet e monitorimit të OJQ Infoqendrës.

REAGIME

Nga ky numër fillojmë t'i publikojmë reagimet në lidhje me përmbajtjet e këtij raporti.

Në mënyrë integrale e publikojmë reagimin të cilin e pranuar në adresën tonë elektronike më datë 26.10.2015 nga ana e zëdhënëses së Gjykatës Supreme:

“Të nderuar,

Me vëmendje e lexuam raportin Tuaj me titull: “Monitor: implementimi i prioriteteve të reformave emergjente” për periudhën kohore prej 01-20.10.2015, të cilin na e dërguat përmes e-mailit, më datë 21.10.2015, në ora 22:25. Në arsyetimin e raportit Tuaj, jepni sqarime se Rrjeti 23 - rrjet i organizatave joqeveritare, i themeluar në muajin korrik të vitit 2015, aktualisht punon në monitorimin e prioriteteve të reformave emergjente, me mbështetjen e Mbretërisë së Holandës, ndërsa raportet e veta i mbështet në hulumtimin dhe përfaqësimin të bazuar mbi prova dhe argumente. Në këtë kontekst, për ne është e papranueshme që në këtë raport të figurojë teksti në lidhje me kryetaren e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, të cilin e keni marrë nga një tekst i publikuar nga autori Sashe Dimovski në internet faqen Prizma më datë 14.10.2015. Këtë e themi meqë teksti i publikuar i këtij autori është mendim i tij personal, i cili është nxjerrë nga konteksti, me ç'rast publiku fiton një përshtypje të gabuar për punën dhe rolin e gjyqësorit dhe veçanërisht të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.

Ngjarja, për të cilën autori flet në tekstin e tij, është një ngjarje e cila ka ndodhur më datë 28.09.2015 dhe në deklaratat gjatë debateve, për asnjë moment nuk u kontestuan rezultatet e sondazhit për gjyqësorin të zbatuar në vitin 2009, me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Shkup dhe as që ka qëllime të këtilla. Nga ana tjetër, nuk është e saktë se sondazhi midis gjyqtarëve, që planifikohet të realizohet përmes Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë do të realizohet që të dëshmohej se nuk ka presione politike në gjyqësor.

Në asnjë rast, mendimi personal i dikujt dhe komentet e njëanshme nuk mund të jenë bazë mbi të cilën mund ta hartoni këtë raport, për të cilin pohoni se e hartoni në bazë të hulumtimeve dhe të dhënave të mbështetura mbi prova dhe argumente.

Për këto shkaqe, ua dërgojmë këtë tekst si Vërejtje nga ana jonë dhe të cilën kërkojmë që ta merrni në konsideratë. Kjo Vërejtje i është dërguar edhe Misionit të OSBE-së në Shkup.”